

# Shkolla dhe arsimimi

[Sistemi Arsimor](#)

[Shkolla obligative](#)

[Arsimimi profesional / Shkollat e mesme](#)

[Universitetet / Shkollat e larta](#)

[Njohja e diplomave](#)

# Sistemi Arsimor

Sistemi arsimor zviceran dallon nga fakti që mundëson një zhvillim të vazhdueshëm personal. Rëndësi të madhe ka arsimimi profesional. Ai krijon bazën për arsimim të mëtutjeshëm apo për studim në një shkollë të lartë.

## Ndërtimi / Përgjegjësitë

Në Zvicër ka dallim mes tri niveleve arsimore që ndërtohen mbi njëri-tjetrin:

- Shkolla obligative (shkolla fillore: kopshti, shkolla fillore dhe niveli i mesëm i ulët (Sekundarstufe I))
- Arsimimi profesional bazik ose shkolla e mesme (Sekundarstufe II)
- Shkollat e larta / Universitetet dhe Arsimimi i Lartë Profesional (Tertiärstufe)

Shteti është përgjegjës për të tri nivelet; detyrat dhe përgjegjësitë ndahen ndërmjet federatës, kantoneve dhe komunave. Prandaj, shkollat dhe sistemet shkollore mund të ndryshojnë mes kantoneve.

## Shkollimi obligativ

Shkolla obligative në kantonin Aargau zgjat 11 vjet. Ajo fillon kur fëmija ka 4 vjet. Nëse fëmijët nuk shkojnë në shkollë pa arsye, prindërit mund të ndëshkohen me gjobë. Të rinjtë që vijnë në kantonin Aargau deri në moshën 16 vjeçare kanë të drejtë të hyjnë në shkollën obligative. Të rinjtë që vijnë më vonë, mund të informohen në Qendrën Këshillimore për Arsimim dhe Profesione Aargau (ask!) për mundësitë tjera.

## Arsimimi pas shkollimit obligativ

Pas shkollës së obliguar, pothuajse të gjithë të rinjtë përfundojnë një arsimim tjetër. Të rinjtë shpesh zgjedhin një arsimim bazik profesional (Berufslehre). Ky arsimim ofron më pas mundësi për arsimim profesional më të lartë. Ai që gjatë apo pas mësures së zanatit bën maturë profesionale, mund të ndjekë një shkollë të lartë profesionale (Fachhochschule). Rreth 20 për qind e të rinjve absolvojnë një maturë gjimnazi (gymnasiale Maturität), e cila mundëson studime në universitet.

## Stipenditë

Përmes stipendive edhe njerëzit që kanë pak të holla mund të absolutojnë zanate ose shkolla. Kjo ka të bëjë me ndihmën për pagesat për arsimim pas shkollës fillore. Edhe të huajt që jetojnë në kantonin Aargau, sipas rrethanave të veçanta mund të përfitojnë nga stipenditë. Para së gjithash, kjo varet nga shtetësia dhe statusi i qëndrimit të studentit, studentes ose prindërve. Seksioni i Stipendive i administratës kantonale mund të japë informata të tjera.

## Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.ciao-aargau.ch/sq/shkolla-dhe-arsimimi/sistemi-arsimor](http://www.ciao-aargau.ch/sq/shkolla-dhe-arsimimi/sistemi-arsimor)

# Shkolla obligative

Shkolla obligative iu ofron fëmijëve një edukim bazë që mundëson për ta çuar tutje. Shkollat publike janë falas.

## Regjistrimi i fëmijës

Për funksionimin e shkollës publike përgjegjëse janë komunat. Që të regjistrohet një fëmijë për shkollë, mund të drejtoheni ose te komuna e banimit ose direkt te drejtori i shkollës në ndërtesën e shkollës.

## Nivelet shkollore

Shkolla obligative ndahet në tri nivele të ndryshme:

- Kopshti (Kindergarten) zgjat 2 vjet.
- Shkolla fillore (Primarschule) zgjat 6 vjet. Fëmijët me nevoja ose aftësi të veçanta mbështeten në mënyrë të veçantë.
- Niveli i mesëm (Sekundarstufe I) zgjat 3 vjet. Në nivelin e mesëm, ka tri lloje të ndryshme shkollore (Realschule, Sekundarschule, Bezirksschule). Ato kanë kërkesa të ndryshme për performancën.
- Fëmijët që nuk flasin gjermanisht mbështeten në mënyrë të veçantë në të gjitha nivelet.
- Informata të hollësishme për shkollën obligative mund të gjenden në broshurën "Shkolla Popullore në Kantonin Aargau".

## Shkollat / private dhe publike

Shkollat publike janë të lira. Djem dhe vajza mësojnë bashkë. Mësimi është neutral në aspektin fetar. Shumica e fëmijëve dhe të rinjve shkollimin e tyre obligativ e kalojnë në shkolla publike (95%). Ka edhe shkolla private. Nëse prindërit i dërgojnë fëmijët e tyre në shkolla private, ata parimisht duhet t'i paguajnë vetë shpenzimet.

## **Të drejtat dhe detyrimet e prindërve**

Shkolla është e detyruar t'i informojë prindërit për përditshmërinë shkollore dhe rezultatet e fëmijëve të tyre në mësim. Për këtë qëllim, organizohen biseda me prindërit (mes personelit mësimor dhe prindërve), mbrëmje informative për prindër (informatat e shkollës për prindërit) dhe informime të ndryshme. Këto janë në përgjithësi të detyrueshme për prindërit. Prindërit janë përgjegjës për shkuarjen me rregull të fëmijës në shkollë. Nëse fëmija nuk mund të shkojë në shkollë (p.sh. për shkak të sëmundjes), prindërit duhet t'a informojnë shkollën për këtë. Ata duhet gjithashtu të kujdesen që fëmijët e tyre t'i kryejnë detyrat e shtëpisë. Nëse prindërit e ndjekin rregullisht punën shkollore dhe detyrat e shtëpisë dhe tregojnë interes për to, ata mund ta mbështesin fëmijën e tyre. Për personat që ende nuk e njohin sistemin arsimor në Zvicër, ka takime informative të veçanta, shpesh edhe në gjuhë tjera përveç në gjermanisht.

## **Pyetje / Mbështetje**

Nëse prindërit kanë pyetje lidhur me shkollën, duhet gjithmonë të drejtohen së pari te mësuesi. Ky mund të ndihmojë edhe nëse prindërit kanë nevojë për mbështetje. Mësuesi gjithashtu do t'u drejtohet prindërve së pari nëse ka ndonjë ndjesi që fëmija ka nevojë për diçka, ose ka pyetje. Është e rëndësishme në përgjithësi që prindërit të kërkojnë kontakt me mësuesit dhe të punojnë ngushtë me ta. Në rastet e vështira psikologjike ose sociale, shërbimi psikologjik shkollor (Schulpsychologischer Dienst) mund t'u ofrojë ndihmë falas fëmijëve dhe prindërve të tyre.

## **Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.ciao-aargau.ch/sq/shkolla-dhe-arsimimi/shkolla-e-detyruar](http://www.ciao-aargau.ch/sq/shkolla-dhe-arsimimi/shkolla-e-detyruar)

## Arsimimi profesional / Shkollat e mesme

Pas shkollës obligative, shumica e të rinjve vendosin të ndjekin një arsimim profesional. Ata që duan të studiojnë në një shkollë të lartë, zakonisht duhet të marrin një diplomë në një shkollë të mesme. Kjo është e mundur edhe në kuadër të një arsimimi profesional.

### Domëthënia e arsimimit

Një arsimim i mirë dhe pozicioni në jetën profesionale kanë një rëndësi të madhe në Zvicër. Rezultatet në shkollën fillore janë shumë të rëndësishme për mundësitë e mëtejshme. Pas kohës së shkollës fillore, të rinjtë kanë shumë rrugë të hapura për të krijuar një pozicion të mirë në jetën profesionale (Sekundarstufe II). Pa më shumë arsimim, është e vështirë të gjeni një punë të mirë. Shërbimet këshilluese për arsimim dhe profesion në Aargau (ask!) këshillojnë të rinjtë dhe prindërit pa pagesë në çështje të arsimimit dhe aftësimin të mëtejshëm.

### Arsimimi profesional bazë

Shumica e të rinjve vendosin të ndjekin një arsimim bazë profesional (Berufslehre) pas shkollës fillore. Në këtë lloj arsimimi, të rinjtë marrin aftësi praktike për profesionin duke punuar në një ndërmarrje dhe krahas kësaj mësojnë në një shkollë profesionale. Ka më shumë se 250 profesione që mund të zgjidhen. Ky arsimim zgjat prej 2 deri në 4 vjet. Të rinjtë duhet ta kërkojnë vetë në një ndërmarrje një vend ku e mësojnë profesionin. Kërkimi fillon në dy vitet e fundit të shkollës fillore. Shkolla i ndihmon të rinjtë, por ata gjithashtu duhet të mbështeten nga prindërit. Shërbimet e këshillimit për arsimimin dhe profesionin në Aargau (ask!) gjithashtu të rinjve iu bëjnë oferta të ndryshme dhe i këshillojnë pa pagesë. Të rinjtë që ndjekin një arsimim bazë profesional mund të fitojnë edhe një diplomë profesionale (Berufsmaturität), qoftë gjatë arsimimit bazë profesional ose pas tij.

## Shkollat e mesme

Shkollat e mesme (Mittelschulen) ofrojnë një arsimim në nivel të përgjithshëm. Këto shkolla përgatitin për arsimim akademik në universitete apo shkolla të larta (Fachhochschulen) profesionale. Bëhet dallimi midis shkollave të mesme që përfundojnë me diplomë të gjimnazit dhe atyre të cilat përfundojnë me një diplomë apo maturë profesionale. Maturiteti gjimnazor mundëson hyrjen në universitetet pa provim. Diploma apo matura profesionale mundëson hyrjen në shkolla të larta pa provim. Megjithatë, shkollat e larta janë gjithashtu të hapura edhe për persona që kanë diplomë gjimnazi dhe universitetet janë gjithashtu të hapura edhe për persona që kanë diplomë ose maturë profesionale (me provim pranues). Në varësi të kësaj, mund të kërkohen kushte shtesë.

## Ofertat urëlidhëse

Të rinjtë nga mosha 16 deri në 21 vjeç, të cilët hyjnë në kantonin Aargau pas përfundimit të shkollimit të detyrueshëm, mund të marrin pjesë, sipas parakushteve të caktuara, në një ofertë urëlidhëse (Brückenangebot) nga shkolla kantonale për aftësimin profesional (Kantonale Schule für Berufsbildung, ksb). Synimi është hyrja në tregun e punës. Një ofertë urëlidhëse mbështet të rinjtë në gjetjen e një praktike apo vendi për mësuarjen e profesionit. Të interesuarit duhet të kontaktojnë shërbimin këshillues për arsimim dhe profesione në Aargau (ask!) ose në Zyrën Qendrore Udhërrëfyese (Anlaufstelle Wegweiser).

## Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.ciao-aargau.ch/sq/shkolla-dhe-arsimimi/arsimimi-profesional--shkollat-e-mesme](http://www.ciao-aargau.ch/sq/shkolla-dhe-arsimimi/arsimimi-profesional--shkollat-e-mesme)

## Universitetet / Shkollat e larta

Zvicra njih dy lloje të shkollave të larta, universitetet dhe shkollat e larta profesionale. Për të aplikuar me dëftesa të maturës si student i huaj, personi duhet të pyes drejtpërdrejt në shkollat e larta.

### Sistemi i shkollimit të lartë

Në shkollat e larta (Tertiärstufe) zvicerane, ka dallim midis universiteteve dhe shkollave të larta profesionale (Fachhochschulen). Në shkollat e larta profesionale më shumë vëmendje i kushtohet mësimit praktik, ndërkohë që në universitete më shumë vihet theksi në mësimin teorik. Këto dy lloje shkollash janë të barabarta dhe janë organizuar në bazë të sistemit evropian të Bolognës. Ato përfundojnë me shkallën Bachelor ose Master, e cila njihet në nivel evropian.

### Pranimi

Në varësi të universitetit të zgjedhur, kushtet e pranimit janë të ndryshme. Me diploma të maturës zvicerane, hyrja në universitete është e garantuar. Diplomat e maturës nga jashtë nuk pranohen në çdo rast. Për të aplikuar për një program studimi, duhet të drejtoheni në universitet (universitet / shkollë të lartë profesionale) ku dëshironi të studioni. Për shumicën e programeve, përgjithësisht kërkohen njohuri të mira të gjuhës gjermane. Disa programe studimi bëjnë përjashtim, duke ofruar mësim komplet në anglisht. Shërbimet e këshillimit për arsimim dhe profesione Aargau (ask!) ju informojnë pa pagesë për mundësitë e ndryshme të studimit në nivelin e tretë të arsimit.

### Arsimimi i lartë profesional

Përveç universiteteve, në Zvicër edhe aftësimi i lartë profesional është një rrugë e dëshiruar për më shumë arsimim. Ajo profesionistëve iu mundëson specializim dhe thellim të njohurive të fushës profesionale dhe marrjen e detyrave drejtuese. Arsimimi më i lartë profesional vazhdon pas arsimimit bazik profesional (Berufslehre). Për këtë nuk kërkohet diplomë e maturës. Shërbimet e këshillimit për arsim dhe profesion Aargau (ask!) ju informojnë pa pagesë për mundësitë e ndryshme.

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.ciao-aargau.ch/sq/shkolla-dhe-arsimimi/universitetet--shkollat-e-larta](http://www.ciao-aargau.ch/sq/shkolla-dhe-arsimimi/universitetet--shkollat-e-larta)



## Njohja e diplomave

Diplomat dhe çertifikatat e huaja nuk janë gjithmonë të vlefshme në Zvicër. Në rrethana të caktuara, megjithatë, është e mundur të pranohen. Për disa profesione kjo është e domosdoshme.

### Njohja

Personave me diplomë të huaj, sipas kushteve të ditura, diplomat mund t'iu njihen në Zvicër. Me njohje vërtetohet se një diplomë ose një certifikatë e huaj është e barasvlefshme me diplomën ose certifikatën zvicerane. Në profesionet e rregulluara (p.sh. profesionistët e kujdesit shëndetësor, mësuesit etj.) njohja është e nevojshme për të pasur mundësi për ta ushtruar profesionin. Për njohjen, sipas profesionit ose arsimit, janë përgjegjëse organe të ndryshme. Njohja kushton. Informatat i jep Zyra Kombëtare për Njohjen e Diplomave (Nationale Kontaktstelle für Diplomanerkennung) ose Shërbimi i Këshillimit për Arsim dhe Profesione Aargau (ask!).

### Vërtetim mbi nivelin e arsimit

Në profesionet e padefinuara me rregulla, nuk është e nevojshme njohja e diplomës ose kualifikimit për të punuar në Zvicër. Për këto profesione, mund të kërkohet një vërtetim i nivelit. Ky vërtetim tregon vlerën e diplomës së huaj në sistemin e arsimit zviceran (Schweizer Bildungssystem). Vërtetimi mund të ndihmojë në kërkimin e punës. Informacione mbi vërtetimin e nivelit mund të kërkohen në byronë e Kontaktit Kombëtar për Njohjen e Diplomave ose në shërbimet këshilluese për arsimimin dhe profesionin në Aargau (ask!).

### Arritja e kualifikimit profesional

Të rriturit me përvojë në profesion, por pa diplomë ose gradë të njohur, mund të marrin diplomë zvicerane të arsimit bazik (beruflichen Grundbildung) ose të arsimit të lartë profesional (höheren Berufsbildung). Procedura varet nga arsimiti paraprak, përvoja në profesion dhe moshën. Në çdo rast, njohuritë e mira në gjermanisht janë kusht i rëndësishëm (nivel B1 / B2 sipas GER). Të interesuarit mund të informohen dhe këshillohen falas nga Portali Hyrës Aargau. Kush merr diplomë profesionale, përmirëson mundësinë e vet në tregun e punës dhe ka qasje në arsimim të mëtutjeshëm.

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.ciao-aargau.ch/sq/shkolla-dhe-arsimimi/njohja-e-diplomave](http://www.ciao-aargau.ch/sq/shkolla-dhe-arsimimi/njohja-e-diplomave)